

Kampet dhe qendrat e internimit në Lushnjë



SEKSIONI

Kampet e Lushnjes

PERIUDHA

1954 - 1990

Kampet dhe qendrat e internimit në Lushnjë ishin pjesë e sistemit të internimit dhe punës së detyruar gjatë regjimit komunist në Shqipëri. Pas vitit 1950, në këto qendra u internuan qindra familje të persekutuar, ndër to familje të njohura politike dhe familje të mëdha shqiptare, si Markagjoni, Pervizi, Bajraktari, Dukagjini, Kokalari, Dine, Vatnikaj, Koliqi, Biçaku, Mulleti, Merlika, Topalli, Alizoti, Kupi, Dosti, Kaloshi, Kolgjini, Mirakaj dhe të tjera. Të internuarit punonin në bujqësi, hapjen e kanaleve dhe tharjen e kënetave, ndërsa jetonin në kushte të vështira dhe nën kontroll e mbikëqyrje të vazhdueshme. Lëvizja e tyre ishte e kufizuar dhe kërkonte leje nga autoritetet. Dokumentet arkivore të paraqitura në këtë seksion dëshmojnë për organizimin e këtyre qendrave dhe jetën e familjeve të internuara në zonën e Lushnjës.

KAMPE INTERNIMI

IZOLIM

DEBIM

Historiku i Kampeve të Lushnjës

Pas mbylljes së kampit të internimit të Tepelenës, në fund të nëntorit 1953, një pjesë e madhe e të internuarve u transferua në zonën e Lushnjës. Savra u përcaktua si një nga qendrat kryesore të internimit dhe si seli e komandës administrative. Familjet e internuara u vendosën fillimisht në baraka dhe iu nënshtruan kontrollit të vazhdueshëm administrativ, apelit të përditshëm dhe detyrimit për të punuar në fermë. Kampi i Savrës, një nga qendrat më të njohura të internimit në zonën e Lushnjës, u hap në vitin 1953 dhe funksionoi deri në vitin 1990. Në të u internuan familje të figurave të njohura politike dhe të disa ish-kryeministrave të periudhës para Luftës së Dytë Botërore. Savra shërbeu si një nga pikat kryesore të organizimit dhe administrimit të sistemit të internimit në zonë. Një tjetër qendër e rëndësishme ishte Kampi i Plugut, i lidhur me Fermën “29 Nëntori”. Sipas burimeve të dokumentimit historik, ky kamp u formua në vitin 1950 si një kamp i rrethuar, ku të internuarit dhe emigrantët u angazhuan në punë të rënda bujqësore. Në vijim, sistemi i internimit u shtri në disa fshatra dhe sektorë të zonës së Myzeqesë, ndër ta Çerma Kamp, Çerma Sektor, Grabiani, Gradishta, Kryekuqi, Karavastaja, Bedati, Plugu, Gjaza, Rrapëza, Kolonja, Dushku, Zhamaja, Sulzotaj dhe Karbunara. Këto qendra shërbyen si vende të vendosjes së detyruar të familjeve të konsideruara nga regjimi si “të rrezikshme” ose “armike”, nën mbikëqyrjen e organeve shtetërore. Të internuarit kishin kufizime të lëvizjes jashtë vendbanimit dhe, për të dalë prej tij, duhej të pajiseshin me leje nga organet përkatëse. Puna bujqësore përbënte një nga elementët kryesorë të jetës së përditshme në këto qendra. Afatet e internimit, shpesh të përcaktuara për pesë vjet, mund të zgjateshin me vendime të Komisionit të Internim-Dëbimeve, duke bërë që internimi i disa familjeve të vijonte për periudha shumëvjeçare. Sistemi i internimit në Lushnjë përbënte një mekanizëm të ndërthurur të kufizimit të lirisë së lëvizjes, kontrollit administrativ, punës së detyruar dhe ndarjes së familjeve nga vendbanimet e tyre. Dokumentacioni arkivor lidhet jo vetëm me vendimet e internimit dhe zgjatjen e tyre, por edhe me administrimin e përditshëm të jetës së të internuarve, lëvizjet, punën, marrëdhëniet me organet shtetërore dhe jetën familjare e shoqërore. Dokumentet e paraqitura në këtë seksion dëshmojnë funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të internimit në zonën e Lushnjës, nga krijimi i qendrave të para deri te shtrirja e tij në fshatrat e Myzeqesë. Ato shërbejnë si burime për studimin e politikave të internimit, mënyrës së administrimit të tyre dhe përvojave individuale e familjare të personave të internuar.

Kartela e Internimit

Kartela e internimit është dokument zyrtar administrativ i krijuar nga strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Ministria e Punëve të Brendshme gjatë regjimit komunist në Shqipëri (1944–1991). Ajo përdorej për regjistrimin, identifikimin dhe mbikëqyrjen e personave ose familjeve të dënuara me internim apo dëbim. Kartela përmbante të dhëna personale, arsyen dhe afatin e dënimit, vendin e internimit, si dhe shënime administrative mbi zbatimin e masës. Sot, këto dokumente administrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) dhe përbëjnë burime arkivore për dokumentimin e historive të internimit dhe të dënimit politik. Në vijim paraqiten katër tipologji kartelash internimi, të viteve 1956, 1957, 1962 dhe 1965, të përzgjedhura për të ilustruar mënyra të ndryshme të zbatimit dhe administrimit të masave të internimit dhe dëbimit gjatë regjimit komunist. Dokumentet pasqyrojnë raste të vendosjes së internimit për “rrezikshmëri shoqërore”, lirimit nga internimi, internimit të anëtarëve të një familjeje dhe kthimit të masës së internimit në dëbim. Së bashku, këto katër raste ndihmojnë në kuptimin e mekanizmave administrative përmes të cilëve internimi dhe dëbimi u zbatuan dhe u kontrolluan nga autoritetet shtetërore.

Kartele tip internimi

MEDIA FAQE #1

Dr-sig-st.

Emërtimi i fondit

Sektori i veprimtarisë

Viti

Rrethi

Kutia Nr.

Arka Nr.

Indeksi

Fondi Nr.

Dosja Nr.

Inventari Nr.

24.

1956.

A

Me vendim komiss. N° 14 dt 21. 11. 56. pr. MPB

interrohet në detyrë sepse parapet rrezikshm.

shpëtor. Dënim fillon më 21.9.56 deri 21.9.61

PËRPILUESI.

DATA

Fleta Nr.

TITULLI

Kartele tip internimi

INFORMACION

Kartele tip internimi

Autoret: Komisioni i Internim Debimeve

	1956
FONDI	6
LLOJI I DOKUMENTIT	Kartele internimi
DATA E KRIJIMIT	21.11.1956
VENDIM	Nr. 14

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

Kartele liri mi nga Internimi

MEDIA FAQE #1

Dr. Sip. Sut

Emërtimi i fondit

Sektor i veprimtarisë

1957

Viti

K4

Rrethi

28

Dosja Nr.

28

Fondi Nr.

Arka Nr.

Indeksi

Fleta Nr.

TITULLI

Udhëzuesi komisi. Nr. 13 dt. 25.12.57 pr. MPB,

lirohet nga intervimi (int në dushinje)

PËRPIJES

DATA

Kartele liri mi nga Internimi

INFORMACION

Kartele liri mi nga Internimi


LLOJI I DOKUMENTIT	Kartele
DATA E KRIJIMIT	25.12.1957

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

Kartele liri mi nga Internimi

MEDIA FAQE #1



Kartele liri mi nga Internimi

INFORMACION

Kartele liri mi nga Internimi

DOSJA	28
DEGA	e Hetuesise
APROVUAR NGA	Komisioni i Internim Debimeve
KRIJUAR NGA	Komisioni i Internim Debimeve
VENDIM	Nr 67 dt 15.08.1962

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

Kartele -Kthimi i masës së internimit në dëbim

MEDIA FAQE #1

Daja Hetuesis
Emërtimi i fondit

Viti 1965

Spektori i veprimtarisë

Fondi Nr. _____ Dosja Nr. 84 Kutia Nr. _____ Arka Nr. _____

Inventari Nr. _____ Indeksi A _____

Fleta Nr. 54 _____

TITULLI, _____

*✓ kthehet internimi në dëbim me vendim
NR 44. dt. 16. 12. 1965. të internuar në
Lushnje me vendim NR 28. dt. 8. 5. 1961. se
paragjishin rrejtshmëri orratje. dëbuar për 5 vjet
korë.*

PËRPILUESI *[Signature]* DATA _____

Kartele -Kthimi i masës së internimit në dëbim

INFORMACION

Kartele -Kthimi i masës së internimit në dëbim


DOSJA	84
VENDIM	Nr. 28 dt. 08.5.1961

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

Vendimi nr. 10, 26 shkurt 1954- Shpërngulja e detyruar e një familjeje

MEDIA FAQE #1




Vendimi nr. 10, 26 shkurt 1954- Shpërngulja e detyruar e një familjeje

MEDIA FAQE #2


Vendim për internim në Kampin nr. 5, Lushnjë – 1954

MEDIA FAQE #1



Vendim për internim në Kampin nr. 5, Lushnjë – 1954

MEDIA FAQE #2



INFORMACION

Vendim për internim në Kampin nr. 5, Lushnjë – 1954


FONDI	49
DOSJA	15
VITI	1954
NR. I FLETEVE	50
LLOJI I DOKUMENTIT	Vendim
NR.	11
DATE	30.01.1954
KOMISIONI	Mehmet Shehu
ANËTARËT	Mihallaq Ziçishti, Nevzat Haznedari, Rexhep Kolli, Jashar Menzelxhiu, Sabri Sevrani

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.


Vendimi nr. 1, datë 10 shkurt 1965, i Komisionit të Internim-Dëbimeve

MEDIA FAQE #1



Vendimi nr. 1, datë 10 shkurt 1965, i Komisionit të Internim-Dëbimeve

MEDIA FAQE #2



Vendimi nr. 1, datë 10 shkurt 1965, i Komisionit të Internim-Dëbimeve

INFORMACION

Vendimi nr. 1, datë 10 shkurt 1965, i Komisionit të Internim-Dëbimeve


FONDI	49
DOSJA	84
VITI	1965
NUMRI I FAQEVE	68
LLOJI I DOKUMENTIT	Vendim
KOMISIONI	Beqir Balluku
ANËTARËT	Kadri Hazbiu, Bilbi Klossi, Aranit Çela, Shuaip Panariti.

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.


Vendimi nr. 3, datë 19.03.1965 – Lushnje

MEDIA FAQE #1



Vendimi nr. 3, datë 19.03.1965 – Lushnje

MEDIA FAQE #2



INFORMACION

Vendimi nr. 3, datë 19.03.1965 – Lushnje


FONDI	49
DOSJA	84
VITI	1965
NUMRI I FAQEVE	68
LLOJI I DOKUMENTIT	Vendim
NR.	3
DATE	19.03.1965
KOMISIONI	Beqir Balluku
ANËTARËT	Kadri Hazbiu, Bilbil Klosi, Thoma Çami, Aranit Çela

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

Vendimi Nr. 5 i Komisionit të Internim-Dëbimeve: Internimi i një personi në sektorin e N.B.SH Gjazë të Lushnjës

MEDIA FAQE #1



Vendimi Nr. 5 i Komisionit të Internim-Dëbimeve: Internimi i një personi në sektorin e N.B.SH Gjazë të Lushnjës

INFORMACION

Vendimi Nr. 5 i Komisionit të Internim-Dëbimeve: Internimi i një personi në sektorin e N.B.SH Gjazë të Lushnjës

FONDI	4
DOSJA	123.1
NUMRI I FAQEVE	79
LLOJI I DOKUMENTIT	Vendim
NR.	5
DATE	18.01.1973
KOMISIONI	Beqir Balluku

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript për këtë media.